



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
SEKRETARIA

Nr.____Prot.

Tiranë, më __.02.2021

MBLEDHJA Nr. 10,
datë 22.02.2021, ora 14:00
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; të ndryshuar, (ii) Rregullores bazë së Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë të miratuar me Vendimin e ERE-s Nr. 144/2019 dhe (iii) nenit 11 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96, datë 16.07.2016, (iv) Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 24.03.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të vecanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19”, të ndryshuar, njoftojmë se **ditën e Hënë, datë 22.02.2021, ora 14:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 10 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi licencimin e shoqërisë “Gerti” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Vardari” me kapacitet të instaluar 1972 kW
2. Mbi licencimin e shoqërisë “Gerti” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike
3. Mbi licencimin e shoqërisë “Aris Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Guri i Zi” me kapacitet të instaluar 1719 kW, Hec “Daznjanë” me kapacitet të instaluar 1518 kW, dhe Hec “Shëlli” me kapacitet të instaluar 1518 kW, me kapacitet total të instaluar 4755 kW
4. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “REI – Energji” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Lingjace 1” me kapacitet të instaluar 1897 kW dhe “Lingjace 2” me kapacitet të instaluar 300 kW, me kapacitet total të instaluar 2197 kW
5. Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k, për vendosje hipoteke dhe barre siguruese/peng në favor të bankës Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a. mbi pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme të krijuara apo që do krijohen nga shoqëria koncesionare "Seka Hydropower" sh.p.k.

Në zbatim të: (i) pikës 1 të Urdhërit të kryetarit të ERE-s nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës

nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19”; (ii) Urdhërit nr. 53/1, datë 24.03.2020 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 53, datë 11.03.2020”, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore” dhe (iii) Urdhërit nr. 53/2 datë 01.06.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore gjatë gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19, mbledhja nuk do të jetë e hapur për publikun.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI